

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat e Mirëqenies Sociale, Mars 2024

24.04.2024

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin mars 2024.

Rritet skema për përkrahje financiare familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara në mars 2024, krahasuar me mars 2023

Në muajin mars 2024, nga skema për përkrahje financiare familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuara kanë përfituar 3 473, ku krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak që ishte 3 088 përfitues, vërehet një rritje prej 12,5%.

Numri i përfituesve nga skemat pensionale dhe skemat e tjera të mirëqenies sociale

Përfituesit e pensioneve dhe skemave tjera sociale	Muaji/Viti		3.2024/ 03.2023
	03.2023	03.2024	
Skema e ndihmës sociale	21 948	19 879	-9,4
Pensionet bazike të moshës	137 103	146 820	7,1
Pensionet kontributpaguese të moshës	47 339	48 358	2,2
Pensionet e personave me aftësi të kufizuara	17 966	19 865	10,6
Pensionet e Trepçës	1 628	1 327	-18,5
Pensionet e Forcave të Sigurisë së Kosovës	716	784	9,5
Pensionet e Trupave Mbrojtëse të Kosovës	1 289	1 333	3,4
Skema e të verbërve	1 760	1 847	4,9
Pensionet Familjare	3 195	2 976	-6,9
Pensionet e Invalidëve të punës	56	45	-19,6
Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike	2 693	2 977	10,5
Skema e kompensimit për punëtorët e arsimit për vitet 90/91 deri në 98/99	13 005	13 816	6,2
Pensionet e familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës	13 027	12 858	-1,3
Veteranët	36 826	36 927	0,3
Skema për përkrahje financiare familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara	3 088	3 473	12,5

Rënie e përfituesve nga skemat e pensioneve, krahasuar me një vit më parë

Në muajin mars 2024, krahasuar me muajin mars 2023, kishte rënie të numrit të përfituesve nga: skema për pensionet invalidore (-19,6%); skema për pensionet e Trepçës (-18,5%); skema e ndihmës sociale (-9,4%) skema për pensionet familjare (-6,9%); skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës (-1,3%).

Rritje e përfituesve nga skemat e pensioneve, krahasuar me një vit më parë

Në muajin mars 2024, krahasuar me muajin mars 2023 kishte rritje të numrit të përfituesve nga: Skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara (10,6%); Pensionet paraplegjike dhe tetraplegjike (10,5%); skema e pensioneve për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) (9,5%); skema e pensioneve bazike të moshës (7,1%); skema e kompensimit për punëtorët e arsimit që punuan gjatë vitit shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 (6,2%); skema e kompensimeve për personat e verbër (4,9%); skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) (3,4%); skema e pensioneve kontribut-paguese të moshës (2,2%); skema për veteranët e luftës (0,3%).

Për më shumë informata lidhur me Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin Mars 2024, vizitoni:
<https://ask.rks-gov.net/Themes/SocialWelfare>